



Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman (CAO)

Raport Auditimi

Auditim i Zyrës së Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman (CAO) të Korporatës
Financiare Ndërkombëtare (IFC)

Përputhshmëria e Zyrës së Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman (CAO)

C-I-R4-Y12-F158

Më 22 Shkurt, 2013

Auditim i Zyrës së Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman i IFC **Projekti i Shërbimeve
Këshillimore me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), Kosovë**

Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë/Ombudsman (CAO)

për

Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC)

Agjensia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA)

Anëtarë të Grupit të Bankës Botërore

Rreth Zyrës së Këshilltarit të Përcputshmërisë së CAO

Qëllimi i CAO është të shërbejë si një mekanizëm i pavarur, burimi i drejte, i besueshëm dhe efektiv dhe të përmirësojë përgjegjësinë Mjedisore dhe Shoqërore të IFC dhe MIGA

CAO (Zyra e Këshilltarit të Përcputshmërisë Ombudsman) është një post i pavarur që raporton direkt tek Presidenti i Grupit të Bankës Botërore. CAO rishikon ankesat e komuniteteve të ndikuara nga zhvillimi i projekteve të ndërmarrë nga dy degët e kreditimit të sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjensia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA).

Për më shumë informacion rreth CAO, ju lutemi vizitoni www.cao-ombudsman.org

Pasqyra e Lëndës

Shkurtime	4
Vështrim i Proçesit të Auditimit të Përputhshmërisë së CAO	5
1. Dokumentacioni i Auditimit	6
2. Një Vështrim i Strkturës së Politikës së IFC dhe Qëndrimi ndaj Ambjentit dhe Shoqërisë për Projektet e Shërbimeve Këshillimore	9
3. Një Vështrim i Projektit të Shërbimeve Këshillimore KEK të IFC	13
4. Gjetjet e Auditimit të CAO	17
5. Përfundimi i Auditimit të CAO	19

Lista e Shkurtimeve

Shkurtim	Përkufizim
AS	Shërbimet Këshillimore
CAO	Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman (IFC dhe MIGA)
CES	Departamenti Mjedisor, Shoqëror dhe i Qeverisjes së IFC
CO ²	Dioksid karboni
CSO	Organizata e Shoqërisë Civile
E&S	Mjedisore dhe shoqërore
EHS	Mjedisit, shëndetit dhe sigurisë
ESRP	Procedurat shqyrtuese të mjedisit dhe shoqërisë
GoK	Qeveria e Kosovës
GIIP	Praktika të mira ndërkombëtare të industrisë
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IFI	Institucioni Ndërkombëtar Financiar
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
KEDS	Shpërndarja dhe furnizimi I energjisë elektrike të Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës (Kosovo Energy Corporation)
M&E	Monitorimi dhe vlerësimi
MIGA	Agjensia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe
NGO	Organizata jo qeveritare
PDS	Përmbledhje e dokumentit të projektit
PS	Standartet e performancës
PSES	Politikat në qëndrueshmërinë mjedisore dhe shoqërore
PSP	Pjesëmarrja e sektorit privat
QAE	Shqyrtimi i cilësisë në hyrje
TL	Udhëheqës i transaksionit
ToR	Termet e referencës

Një Vështirm i Proçes it të Auditimit të Përputhshmërisë së CAO

Kur CAO merr një ankesë rreth një projekti të IFC ose MIGA, fillimisht e dërgon ankesën tek Ombudsman i CAO, i cili punon ti përgjigjet ankesës nëpërmjet marrëveshjeve lehtësuese, nëse është e përshtatshme. Nëse Ombudsman i CAO konkludon që palët nuk janë të gatshme apo të afta të arrijnë një zgjidhje të lehtësuar, çështja është transferuar tek dega e Përputhshmërisë së CAO, e cila vlerëson shqetësimet e ngritura në ankesë për një auditim të Përputhshmërisë së IFC ose MIGA. Një auditim i Përputhshmërisë mund të fillojë gjithashtu prej kërkesës nga Presidenti i Grupit të Bankës Botërore ose nga megaxhimi i lartë i IFC ose MIGA.

Auditimi i Përputhshmërisë së CAO fokusohet në IFC dhe MIGA, dhe se si IFC/MIGA siguron veten/veten e tyre në efektshmëri dhe projektit. Qëllimi i auditimit të CAO është të sigurojë përputhshmëri me politikën, standartet, udhëzimet, procedurat, dhe kushtet për përfshirjen e IFC/MIGA, dhe në këtë mënyrë të përmirësojë efektshmërinë mjedisore dhe shoqërore të investimeve dhe aktiviteteve të mbështetura nga IFC/MIGA. Në shumë raste, në vlerësimin e efektshmërisë së projektit dhe zbatimin e masave të plotësojë kërkesat përkatëse është e nevojshme të rishikohen veprimet e sponsorit të projektit dhe të verifikohen rezultatet në fushë.

Një auditim Përputhshmërie duhet të mbetet brenda qëllimit të kërkesës ose ankesës origjinale. Auditimi i Përputhshmërisë nuk mund të shkojë mbi kufijtë e ankesës, ose të kërkojë të adresohen çështje të tjera. Në raste të tilla ankuesi ose kërkuesi mund të konsiderojë paraqitjen e një ankesë ose kërkesë të re.

Vlerësimet dhe auditimet e Përputhshmërisë së CAO konsiderojnë se si IFC/MIGA siguron veten/veten e tyre në përputhje me ligjin kombëtar, reflektimim e angazhimeve ndërkombëtare ligjore së bashku me kritere të tjera të auditimit. CAO nuk ka autoritet për të përkjet proceseve gjyqësore. CAO nuk është as gjykatë apeli as mekanizëm i zbatimit ligjor, CAO gjithashtu nuk është as zëvendësues për sistemet e gjykatës ndërkombëtare ose sistem gjyqësor në vendet pritëse.

Në rastet ku IFC/MIGA është/janë gjetur jashtë Përputhshmërisë, CAO do mbajë audit të hapur dhe do të vëzhgojë situatën deri sa veprimet e marra nga IFC/ MIGA sigurojnë CAO që IFC/ MIGA do të kthehen në Përputhshmëri. Atëherë CAO do të mbyllë auditimin.

1. Dokumentacioni i Auditimit

Më 25 Gusht, 2011, CAO mori korrespondencë nga ankuesit në Kosovë të cilët kërkuan që identitetet e tyre të mbahen në konfidencialitet. Ankesa ishte mbështetur (bashkë firmosur) nga organizata jo qeveritare locale të Kosovës (NGOs) dhe organizata jo qeveritare ndërkombëtare dhe ngrinte shqetësime rreth një projekti për Shërbimet Këshillimore të IFC, projekti numer (# 29107) dhe efektet e tij pasuese nga privatizimi i kompanisë së shërbimeve në pronësi publike të Kosovës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Ankuesit dyshonin që privatizimi i KEK ngrinte shqetësime të rëndësishme mjedisore dhe shoqërore, përfshirë humbjen e punësimit si rrjedhojë e privatizimit, efekte negative në të drejtat e shoqatës; ata pohonin mungesë të Përpunueshmërisë së IFC's me Politikën e Qëndrueshmërisë shoqërore dhe mjedisore dhe politikën e përhapjes së informacionit; Dështimi i supozuar i IFC të siguronte që kishte akses të mjaftueshëm informacioni lidhur me procesin e privatizimit dhe aftësisë së klientëve të adresonin efektet negative të privatizimit; dhe dështimi i supozuar i IFC të sigurojë që klienti i IFC (Qeveria e Kosovës) ndoqi standartet e performancës përkatëse kur privatizoi KEK.

Shërbimet Këshillimore të këtij projekti të IFC kishin për qëllim të ndihmonin qeverinë e Kosovës me ndarjen e aktiviteteve të shpërndarjes së pronësisë së KEK dhe me dizajnimin dhe zbatimin e privatizimit të një kompanie të veçantë për shpërndarjen dhe furnizimin e elektrikut. Projekti i Shërbimeve Këshillimore kishte dy faza. Faza e parë ishte një rshikim i fizibilitetit të prezantimit të pjesëmarrjes së sektorit privat në prespektivën e shpërndarjes së rrjetit dhe funksionet e furnizimit të KEK. Pas përcaktimit që një pjesëmarrje e sektorit privat ishte i zbatueshëm nga prespektiva e tregut dhe përfitues për vendin, faza e dyte ishte prezantimi i një procesi tenderi të tërhiqte investoret privatë me fonde të mjaftueshme dhe ekspertizë të korrigjonte dështimet operacionale të KEK me (mbistaf të lartë, menaxhim të pamjaftueshëm, pajisje të vjetra jashtë kohe) dhe probleme financiare (nga norma të ulëta të mbledhjes së tarifave, në veçanti).¹ Qëllimi i punës së IFC ishte të fokusohet vetëm në privatizimin e shpërndarjes së biznesit të KEK. KEK mori këshillim nga këshilltarë të tjerë në aspekte të tjerë të operimit të KEK.

Ankesat ngritën disa shqetësime mjedisore dhe shoqërore në lidhje me Procesin e privatizimit.

- *Vlerësimi Ligjor i Mjedisit dhe Shoqërisë:* Ankuesit argumentuan që studimet e efekteve mjedisore dhe shoqërore të rolit Këshillimor të IFC dhe efekteve pasuese në sektorin energjetik ishin të pamjaftueshme. Më konkretisht, ankuesit pohuan që projekti i Shërbimeve Këshillimore të IFC nuk ishte në përputhje me Standartin permbushës numër 1 të IFC (Vlerësimi shoqëror dhe mjedisor dhe sistemet e manaxhimit) dhe Standarti i përmbushjes numer 2 (Puna dhe kushtet e punës), dhe implikimet mjedisore dhe shoqërore të objekteve shoqëruese (veçanërisht një minierë qymyri linjit dhe fabrika e djegies së qymyrit) si pasojë e privatizimit të KEK nuk ishin konsideruar.
- *Shkurtimet dhe të drejtat e shoqatës:* Ankuesit shprehën shqetësimet që privatizimi do të çonte në humbjen e punësimit (shkurtimet) në të dy sektorët atë të shërbimeve dhe

¹ Shiko publikimin në faqen e internetit të IFC

<http://www.ifc.org/ifcext/spiwebsite1.nsf/b1e2a5a8fc40cd238525753d00658ca9/852568b10055270d852576b0007a3338?opendocument>

në sektorin e gjerë të energjetikës, dhe që planet për shkurtime kanë qenë të papërshtatshëm. Ata gjithashtu shprehën që të drejtat e shoqatës mund të dëmtoheshin si rrjedhojë e privatizimit.

- *Legjislacioni Kombëtar dhe Ndërkombëtar:* Ankuesit ngritën shqetësimet që projekti I Shërbimeve Këshillimore të IFC dhe efektet pasuese në veprimet e Qeverisë së Kosovës drejt privatizimit mund të jenë në kontradiktë me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare të tilla si: Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) që garantojnë punën dhe të drejtat e shoqatave, si edhe udhëzimet e Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut dhe biznesit.
- *Përhapja e informacionit dhe konsultimi me komunitetin:* Ankuesit argumentuan që përhapja e informacionit rreth përfshirjes së IFC në privatizimin e KEK, dhe procesi i privatizimit, kanë qenë të pamjaftueshme dhe nuk u ndermorrën në kohën e duhur. Ata deklarojnë që palëve të interesuara nuk iu dha informacioni i përshtatshëm rreth rreziqeve ekonomike, mjedisore dhe shoqërore lidhur me privatizimin e KEK, ose opsionet potenciale për të zbutur këto rreziqe. Ata debatojnë që kjo është në mospërputhje me Politikën e përhapjes së informacionit të IFC. Ankuesit gjithashtu debatuan që konsultimi për të gjithë privatizimin e projektit të Shërbimit Këshillimor ishte i pamjaftueshëm dhe duhet të kish qenë më gjithëpërfshirës e i gjerë. Ata argumentuan që konsultimet nuk morrën pjesë gjatë vlerësimit të projektit të Shërbimeve Këshillimore dhe fazës së selektimit.

Vlerësimi i Përputhshmërisë së CAO² gjeti si më poshtë:

- *Vlerësimi ligjor i mjedisit dhe shoqërisë:* Dokumentacioni i IFC demonstroi që rreziqet mjedisore dhe shoqërore të ngritura si pasojë nga ankuesit u identifikuan në inspektimin e projektit të shërbimeve këshillimore.
- *Shkurtime dhe të drejtat e shoqatës:* Dokumentacioni i IFC demonstroi që komentet e projektit të Shërbimeve Këshillimore identifikuan rreziqet e shkurtimeve. Komentet fillestare nuk theksuan veçanërisht të drejtat e shoqatës si një rrezik të mundshëm me projektin e Shërbimeve Këshillimore ose privatizimit.
- *Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar:* Dhunimi i legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar nuk u theksua specifikisht si një rrezik gjatë vlerësimit fillestar të IFC. Sidoqoftë në komunikimet pasuese me organizatat joqeveritare lokale të Kosovës, IFC bëri të ditur që IFC kishte siguruar veten që projekti i Shërbimeve Këshillimore ishte në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar.
- *Përhapja e informacionit dhe konsultimi me komunitetin:* Përhapja e informacionit dhe konsultimi i komunitetit nuk ishin theksuar si çështje shqetësuese në komentet fillestare të projektit të Shërbimeve Këshillimore. Sidoqoftë, komunikimi i mëpasshëm midis organizatave jo qeveritare lokale të Kosovës dhe IFC dëshmon që IFC u përpoq të nxisë komunikimin midis qeverisë së Kosovës dhe publikut duke inkurajuar qeverinë e Kosovës të komunikojë modelin e biznesit për privatizimin me publikun.

² Shiko Raportin Vlerësues të CAO për Kosovë KEK tek http://www.cao-ombudsman.org/documents/CAO_Appraisal_Report_C-I-R7-Y12-F158_ENG.pdf (Hyre më 11 Shkurt, 2013)

- *Qëllimi i projektit të Shërbimeve Këshillimore i IFC për Qeverinë e Kosovës: Vlerësimi i CAO gjeti udhëzime potencialisht të pamjaftueshme për stafin të informonte vendimin e tyre se si të përkufizonin qëllimin e projektit të Shërbimeve Këshillimore dhe shtrirjen në të cilën udhëzimet për përkufizimin e këtij qëllimi janë në përputhje me politikat më të gjera të IFC mbi qëndrueshmërinë.*

CAO gjeti që përshkrimi i IFC i qëllimit të punës të projekteve të Shërbimeve Këshillimore, dhe arsyeja themelore për qëllimin e shqyrtimit të dilgjencës ligjore, ishin të paqartë. CAO gjithashtu pyeti se si IFC siguroi veten që efektet pasuese dhe rezultatet e shërbimeve Këshillimore janë në përputhje me efektet e dëshiruara të dispozitave politike të IFC.

CAO gjithashtu shikoi procedurat dhe udhëzimet për përcaktimin e qëllimit të një projekti në Shërbimet këshillimore, specifikisht me qëllim të kuptojë masën në të cilën struktura e politikavë të IFC ishte konsideruar në përkufizimin e qëllimit të IFC dhe konsiderimet e implikacioneve për objektet shoqëruese dhe rezultatet e projektit.

CAO konkludoi që një auditim ishte i merituar. CAO auditoi IFC, dhe se si IFC siguroi veten në efektshmëinë mjedisore dhe shoqërore të investimeve dhe aktiviteteve të veta. Auditimi fokusohet në IFC, dhe nëse proceset dhe procedurat e aplikuara të IFC ishin të përafuara dhe në përputhje me dispozitat e politikës më të gjerë të IFC. CAO nuk auditon klientin e IFC; kështu që CAO nuk miraton ndonjë gjykim në efektshmërinë e klientit të IFC.

Udhëzimet Operative të CAO konstatojnë që çështja në shqyrtim është:

- Nëse rezultatet aktuale shoqërore ose mjedisore të këtyre projekteve janë në përputhje ose në kontradiktë me efektet e dëshiruara të dispozitave politike; dhe
- Nëse ekzistonte ndonjë neglizhim të adresonte çështjet shoqërore ose mjedisore si pjesë e procesit të inspektimit —dhe nëse po, nëse keto neglizhime rezultuan në rezultatet që janë në kundërshtim të efektit të dëshiruar të dispozitave politike.

Duke ndjekur këtë linjë kërkimi përfshiu përgjigjen e pyetjeve në vazhdim:

- Si përcaktoi IFC se cilat dispozita mjedisore dhe shoqërore ishin të aplikuara për një aktivitet të veçantë biznesi?
- C'farë ishte qëllimi kryesor i aplikimit të këtyre dispozitave ndaj aktivitetit të veçantë të biznesit?
- Deri në ç'farë mase IFC siguroi veten që dispozitat e përzgjedhura ishin zbatuar dhe kishin efektin e dëshiruar?

2. Vështrim i Strukturës Politike të IFC dhe Mënyra e Afrimit tek Mjedisi dhe Shoqëria për Projektet e Shërbimeve Këshillimore

2.1 Mandati i IFC

Artikujt e Shoqatës së IFC shprehen që IFC është e mandatuar të shtyjë përpara zhvillimin ekonomik nëpërmjet inkurajimit të rritjes së sipërmarrjes prodhuese private, veçantërisht në vendet më pak të zhvilluara, nëpërmjet “duke ndihmuar në financimin e ndërmarrjeve prodhuese private që do të kontribuojnë në zhvillimin e vendeve anëtarësuese duke bërë investime.”³

Mandati i IFC, siç specifikohet në artikujt e sajë të shoqatës, shprehet që IFC nuk do të pretendojë përgjegjësi për menaxhimin e ndonjë sipërmarrje në të cilën ka investuar dhe as nuk do të ushtrojë të drejtën e votës për këtë qëllim dhe që është brenda fushëveprimit të kontrollit menaxherial, IFC nuk duhet as të ndërhyjë në çështjet politike të ndonjë anëtari/e ose të lejojë ndonjë gjë por konsideratat ekonomike të jenë relevante të vendimeve të saja.

2.2 Struktura e Qëndrueshmërisë së IFC

Struktura e qëndrueshmërisë e IFC bën të qarta premtimet strategjike të IFC të mbështesë zhvillimin. Struktura e qëndrueshmërisë e vitit 2006 konsiston në politikën e qëndrueshmërisë shoqërore dhe mjedisore të IFC, standartet e performancës së IFC, dhe politikën e zbulimit të informacionit të IFC. Një përmbledhje e adoptuar e fundit e vitit 2012 të strukturës së qëndrueshmërisë që ka lidhje me Shërbimet Këshillimore është paraqitur në seksionin 2.5.

2.3 Politika e IFC në Qëndrueshmërinë Shoqërore dhe Mjedisore dhe Standartet e Performancës së IFC

Politika e IFC në Qëndrueshmërinë Shoqërore dhe Mjedisore dhe Standartet e Performancës së IFC, kërkon që klientët të jenë vlerësuar për mundësinë e dëmit mjedisor dhe/ose shoqëror krijuar nga aktivitetet e tyre mbi bazë të shqyrtimit të procedurave mjedisore dhe shoqërore të IFC.^{4,5}

Politikat në qëndrueshmërinë mjedisore dhe shoqërore dhe standartet e performancës së IFC përshkruan me hollësi interpretimin e IFC së një objekti të lidhur. Një objekt i lidhur është

³ IFC, 1993, “Artikujt e Marrëveshjes IFC.”

<http://www1.ifc.org/eps/ecom/connect/1c95b500484cb68d9f3dbf5f4fc3f18b/articles.pdf?MOD=AJPERES>. (Hyrë më 3 Maj, 2012).

⁴ Politika e Qëndrueshmërisë IFC (2006) dhe Standartet e Performancës së IFC (2006) ishin të aplikueshme në këtë projekt. Shiko aplikimin e Politikës në Qëndrueshmërinë Shoqërore dhe Mjedisore dhe Standartet e Performancës së IFC tek

http://www1.ifc.org/eps/ecom/connect/Topics_Ext_Content/IFC_External_Corporate_Site/IFC+Sustainability/Sustainability+Framework/Sustainability+Framework+-+2006/ (Hyrë më 5 Shkurt, 2013).

⁵Versioni 4.0 i Shqyrtim i Procedurave Mjedisore dhe Shoqërore (Gusht 2009) ishin procedurat e aplikuar për këtë projekt. Ato mund të gjenden në

<http://www1.ifc.org/wps/wcm/connect/1fcd4880488559908374d36a6515bb18/ESRP2009.pdf?MOD=AJPERES&attachment=true&id=1322807821599> (Hyrë më 5 Shkurt, 2013).

përcaktuar si një objekt që “nuk finanohet si pjesë e projektit (financimi mund të sigurohet veçantë nga klienti ose nga palët e treta përfshirë qeverinë), dhe zbatueshmëria dhe egzistenca e të cilës varet ekskluzivisht në projekt dhe të mirat ose shërbimet janë thelbësore për funksionimin e suksesshëm të projektit.”⁶

Procedurat shqyrtuese të mjedisit dhe shoqërisë i kërkoi IFC të rishikojë në përgjithësi rreziqet e reputacionit me një klient, si edhe rrezikun potencial të mjedisit dhe shoqërisë lidhur me projektin e Shërbimeve Këshillimore. Një vlerësim në mënyrë tipike përfshin një rishikim të informacionit në sferën publike, një përcaktim nëse efektet dhe rezultatet kanë rreziqe potenciale ekonomike dhe shoqërore, dhe një egzaminim i masave zbutëse për rreziqe të tilla.

Struktura e dilgjencës ligjore e IFC për projektin e Shërbimeve Këshillimore që nuk janë të lidhura me investimet e IFC, si në rastin e procedurave shqyrtuese të mjedisit dhe shoqërisë është udhëhequr nga procedura për Vetë- Mbështetje e projekteve të Shërbimeve Këshillimore.⁷

2.4 Proçeset Mjedisore dhe Shoqërore të IFC lidhur me Shërbimet Këshillimore

Kur IFC filloi projektin e Shërbimeve Këshillimore me Qeverinë e Kosovës ishte duke operuar nën politikën e qëndrueshmërisë shoqërore dhe mjedisore të vitit 2006. Kjo politikë nuk është specifike përse i përket aplikimit të Standarteve të Performancës për projektet e Shërbimeve Këshillimore të IFC. Seksioni “Qëllimi i kësaj Politike” thotë që “IFC kërkon të sigurojë që projektet që financon operohen në përputhje me kërkesat e standarteve të performancës.”

Seksioni “Rolet dhe Përgjegjësia” i IFC përshkruan rolet e IFC dhe të klientit. Përsa i përket klientit seksioni thotë: “Në veprimtarinë e sajë IFC pret që klientët të menaxhojnë rreziqet shoqërore dhe mjedisore dhe efektet e projekteve të tyre. Kjo përfshin vlerësimin e këtyre rreziqeve dhe efekte nga klientët dhe zbatimin e masave të plotësojnë në përputhje me kërkesat e “Standarteve të Performancës”. Përsa i përket IFC, seksioni thotë që roli i IFC është “të rishikojë vlerësimin e klientit; Të ndihmojë klientin në hartimin e masave të mënjanojë, minimizojë, dhe lehtësojë ose kompensojë për efektet shoqërore dhe mjedisore në përputhje me Standartet e Performancës.”⁸

Nën seksionin e Shërbimeve Këshillimore, është përdorur fjalëzim tjetër: “Kur IFC jep këshillë për projekte investuese të një shkalle të madhe, standartet e performancës janë përdorur si një referencë krahas ligjeve kombëtare.”

⁶ Shiko Standartet e Performancës së IFC (2006), Standart I Performancës 1, faqa 2 http://www1.ifc.org/wps/wcm/connect/Topics_Ext_Content/IFC_External_Corporate_Site/IFC+Sustainability/Sustainability+Frame&ork/Sustainability+Framework+-+2006/Performance+Standards+and+Guidance+Notes/ (Hyrë në 5 Shkurt, 2013).

⁷ Shiko IFC Shqyrtim i Procedurave Mjedisore dhe Shoqërore 2009 (Versioni 4) për detaje të mëtejshme. <http://www1.ifc.org/wps/wcm/connect/1fcd4880488559908374d36a6515bb18/ESRP2009.pdf?MOD=AJPERES&attachment=true&id=1322807821599>

⁸ Politika në Qëndrueshmërinë Shoqërore dhe Mjedisore (2006), f. 2.

Kur filloi projekti I Shërbimeve Këshillimore, nuk egzistonin procedura të qarta të qeverisjes së projektit për Shërbimet Këshillimore.⁹ CAO kupton që procedura si udhëzime zakonisht ishte siguruar nga Zëvendës Presidenti ose Drejtori në Përgjegjësi. Ky udhëzim, *Ndihma Teknike dhe Proçesi i Miratimit të Shërbimeve Këshillimore*, ishte ofruar në vitin 2005 dhe updated në vitin 2006.

Për të aprovuar një projekt të Shërbimeve Këshillimore, ai duhet të proçesohet nëpërmjet fazave në vazhdim:

- Rishikimi i cilësisë në hyrje
- Përmbledhja e dokumentit të projektit. Rishikimi fillestar
- Aprovimi përmbledhjës së dokumentit
- Hartimi dhe firmosja e dokumenteve ligjore.

Rishikimi i proçedurave mjedisore dhe shoqërore të IFC¹⁰ përcakton që udhëheqësi i transaksioneve të IFC në projektin e propozuar do të përfshijë specialistin e departamentit mjedisor dhe shoqëror të IFC dhe një përfaqësues të qëndrueshmërisë së Shërbimeve Këshillimore si një koleg inspektimi¹¹ tek faza e aprovimit të përmbledhjes së dokumentit të projektit në rast se udhëheqësi i transaksioneve parashikon që egzistojnë rreziqe të mundshme mjedisore dhe shoqërore lidhur me projektin ose rrezik reputacioni mjedisor dhe shoqëror lidhur me klientin e Shërbimeve Këshillimore.

2.5 Rishikimet e Strukturës së Qëndrueshmërisë në vitin 2012

Duke ndjekur konsultim të brendshëm dhe të jashtëm gjithë përfshirës IFC nxorri një strukturë qëndrueshmërie të rishikuar përfshirë versionet e rishikuara të standarteve të performancës dhe akses të politikës së informacionit që janë efektive për aktivitetet¹² e zhvilluara pas Janarit 2012.¹³ Ndryshimi më i rëndësishëm për projektin e Shërbimeve Këshillimore është ndryshimi nga kërkohet që “Kur IFC jep keshillim për projektet me investim në shkallë të gjerë, standartet e performancës janë përdorur si një reference krahas ligjeve kombëtare” si në vazhdim: “Në rast se rishikimi rezulton në identifikimin e rreziqeve mjedisore dhe/ose shoqërore, këshilla e ofruar klientëve duhet të jetë në përputhje me standartet e performancës si një strukturë praktikave të mira të indistisë ndërkombëtare.”

2.6 Konteksti Ligjor I IFC dhe Përhapja në Publik

⁹ Projekti Shërbimet Këshillimore i Procedura e Qeverisjes u formalizua fillimisht në politikë dhe document procedure në Maj 2011.

¹⁰ Versioni 4.0, Gusht 2009.

¹¹ Kolegëve investigues i'u kërkohet të sigurojnë leje niseje për një projekt të vazhdojë brenda 7 ditësh; në të kundërt, leje nisa është automatike.

¹² Përsa i përket Strukturës së Qëndrueshmërisë së IFC të (2012), f.3 “aktivitetet përfshijnë (i) investimet e financuara direkt nga IFC; (ii) investimet e zbatuara nëpërmjet ndërmjetësve financiarë ose të menaxhuar nga kompania menaxhimit të aseteve të IFC ose ndonjë ndihmës tjetër i IFC, si edhe investimet e financuara pjesërisht ose plotësisht nga donatorët; dhe (iii) shërbimet këshillimore”.

¹³ IFC, 2012, IFC Struktura e Qëndrueshmërisë–Eftektive më 1 Janar, 2012.

http://www1.ifc.org/wps/wcm/connect/topics_ext_content/ifc_external_corporate_site/ifc+sustainability/publications/publications_handbook_sustainabilityframework (Hyre më 9 Maj, 2012).

Politika e IFC mbi Përhapjen e Informacionit, e cila është pjesë e strukturës së qëndrueshmërisë së 2006, thotë shprehimisht që “IFC vë në dispozicion informacionin përsa i përket aktiviteteve të saja që do t’iu jap mundësi klientëve të sajë, partnerëve, dhe palëve të interesuara (përfshirë komunitetet e ndikuara), dhe anëtarët e tjerë të interesuar të publikut të kupojnë më mirë, dhe të angazhohen në diskutimet e informuara rreth aktiviteteve të biznesit të IFC, zhvillimi i përgjithshëm dhe efektet e tjera të aktiviteteve të saja dhe kontribimit të sajë në zhvillim” (paragrafi 8).

Paragrafi 9 i politikës thotë shprehimisht që “ekziston një presupozim në favor të përhapjes së informacionit,” por që “në përputhje me praktikën e bankave tregtare dhe më shumë me institucionet financiare të sektorit publik (për investimet e tyre të sektorit privat), IFC nuk përhap në publik informacion financiar, biznesi, pronësie ose informacion tjetër jopublik i ofruar IFC nga klientët e sajë ose palët e treta. Ta bëjë publik - të tillë do të jetë në kundërshtim me pritshmëritë e ligjshme të klientëve të sajë, të cilët kanë nevojë të jenë në gjendje ti japin IFC informacion të detajuar pa frikën e rrezikut të konfidencialitetit të projekteve të tyre ose informacion tjetër pronësie në një treg shumë konkures.”

Ndërsa politika e IFC në përhapjen e informacionit (2006) inkurajon përhapjen e informacionit, nuk ishte kërkesë e qartë për përhapjen e informacionit në publik në lidhje me ndonjë projekt të Shërbimeve Këshillimore të IFC. Kushtet janë detyruese në themelimin dhe financimin e assistencës së re teknike dhe programet e Shërbimeve Këshillimore ose objekteve 30 ditë pas aprovimit të IFC.

3. Një Vëshrim i Projektit të Shërbimeve Këshillimore KEK të IFC

3.1 Vështrim I Zhvillimit të Projekteve Këshillimore të IFC

Historikisht, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ishte një kompani operuese shtetërore me tre linja kryesore biznesi: miniera; prodhimi i energjisë; dhe shpërndarja dhe furnizimi I shërbimeve në të gjithë Kosovën. Në vazhdim të disa përpjekjeve të mëparëshme privatizimi, shpërndarja dhe furnizimi I shërbimeve elektrike Kosovë u inkorporua në Gusht 2009 me qëllim të transferojë shpërndarjen dhe furnizimin e shërbimeve elektrike Kosovë në një company të re. Sidoqoftë, në May 2011, IFC bëri të ditur që ajo nuk priti shpërbërjen e pasurive aktuale relevante për shërbimet e shpërndarjes nga KEK tek Shpërndarja dhe Furnizimi Elektrik (KEDS) të jenë ndërmarrë deri sa blerësi i zgjedhur ishte bërë i njohur. KEDS u ofrua tregut privat si një entitet më vete, me këshillën e transaksionit nga IFC.

IFC filloi fazën e parë të para zbatimit të këtij projekti më 29 Tetor, 2009. Takimi Shqyrtimi I Cilësisë në Hyrje u mbajt më 9 Nëntor 2009. Në këtë mbledhje, u vendos që çështjet mjedisore dhe shoqërore, përsa i përket procedurave shqyrtuese të mjedisit dhe shoqërisë ishin për tu konsideruar në rishikimin e hershëm të përmbledhjes së dokumentit të projektit dhe jo tek faza e aprovimit të përmbledhjes së dokumentit të projektit, në të cilën CAO kupton të ishte praktika në atë kohë. Sipas kuptimit të CAO, marrëveshja ligjore ("Marrëveshja e Shërbimeve Këshillimore") u firmos me klientin më 13 Nëntor, 2009. Përmbledhja e dokumentit të projektit rishikimi i hershëm përfundoi më 11 Nëntor, 2009 dhe u aprovua më 17 Nëntor, 2009. Kontakti i parë I dokumentuar me departamentin e qeverisjes mjedisore dhe shoqërore të IFC's ishte më 12 Nëntor, 2009. Aprovimi I përmbledhjes së dokumentit të projektit përfundoi dhe u aprovua më 14 Dhjetor, 2009. IFC e bëri të ditur projektin publikisht më 28 Janar, 2010.

3.2 Vlerësimi Ligjor i Mjedisit dhe Shoqërisë së IFC dhe Ndjekja

Përmbledhja e dokumentit të projektit të IFC rishikimi i hershëm i projektit të Shërbimeve Këshillimore KEK dhe aprovimi i Shërbimeve Këshillimore përmbledhja e dokumentit të projektit (respektivisht më Nëntor 17, 2009, dhe më 14 Dhjetor, 2009), identifikoi disa rreziqe mjedisore dhe shoqërore lidhur me projektin e Shërbimeve Këshillimore:

- Rreziqet e reputacionit mjedisor dhe shoqëror ishin identifikuar në lidhje me klientin. Më konkretisht, mekanizma të dobët për monitorimin e mjedisit në Kosovë ishin identifikuar si një rrezik potencial lidhur me klientin. IFC deklaroi – do të punojë me institucione të tjerë financiarë ndërkombëtarë prezentë në Kosovë të promovojë zhvillimin dhe aplikimin e mekanizmave mjedisorë për monitorimin.
- Rreziqet mjedisore, nga që 80 përqind e elektricitetit u prodhua nga linjiti (qymyr ngjyre kafe). Sidoqoftë, si një efekt pozitiv i privatizimit, IFC besoi që Pjesëmarrja e Sektorit Privat (PSP) do të kontribuonte në uljen e humbjeve të shpërndarjes dhe rrjedhimisht pjesërisht në uljen e nivelit të përgjithshëm të emisiveve të dioksidit të karbonit CO².
- Shërbimet e shpërndarjes dhe furnizimit të KEK ishin identifikuar të kishin staf të tepërt. Pushimet nga puna ishin të pamënjanueshme për të arritur operacionet fitimprurëse, rekomandimet e "Manualit udhëzues për praktikën e mirë për shkurtimet" ishin për tu përdorur si masa lehtësuese.

Specialistët e departamenteve të Mjedisit, Shoqërore dhe Qeverisjes të IFC ishin konsultuar të identifikonin rreziqet dhe krijonin treguesit për monitorimin dhe vlerësimin që do të ndiqnin progresin drejt lehtësimit të rreziqeve të lidhura. Imputi i specialistit të Departamenti Mjedisor, Shoqëror dhe i Qeverisjes së IFC ishte përfshirë tek faza e aprovimit të përmbledhjes së dokumentit.

Si pjesë e Diligjencës ligjore të IFC, IFC kontrakttoi një palë të tretë të jashtme të kryejë një shqyrtim të çështjeve mjedisore lidhur me shpërndarjen dhe furnizimin e shërbimeve dhe të furnizojë shërbimet e biznesit të Korporatës Energjetike të Kosovës. Raporti (Shkurt 2011) identifikoi zonat prioritare si në vazhdim ku ishte menduar që anketa të mëtjshme do të ishin të nevojshme të kuptojnë natyrën e rreziqeve mjedisore, shëndetësore, dhe rreziqet e sigurisë lidhur me performancën në biznesin e shpërndarjes të Korporatës Energjetike të Kosovës:

- Kabllot e lënghëm të mbushur
- Shkarkimet në ujë
- Tokë e ndotur
- Menaxhimi i Poliklorurbifenol (që bëjnë pjesë në kimikatet organike të njohura si hidrokarburet e kloruara)
- Menaxhimi i mbetjeve (përfshirë menaxhimin e asbestos)
- Rrezik përmbajtje.

Këto përfundime ishin përfshirë në dokumentacionin e vlerësimit të IFC (Memo e Mjedisit dhe Shoqërisë Shërbimet Këshillimore të IFC më datë 7 Shtator, 2011). Memo e mjedisit dhe shoqërisë vinte në dukje që diligenca ligjore për këtë projekt filloi në Shkurt 2010, dhe gjithashtu vinte në dukje që në atë kohë nuk kishte procedura formale të dizenuara të kryenin vlerësimet e rreziqeve mjedisore dhe shoqërore për Shërbimet Këshillimore. Proçesi për dizenjimin e proçedurave formale për Shërbimet Këshillimore filloi në Tetor 2010 kur një njësi e dedikuar për projektet e Shërbimeve Këshillimore ishte krijuar nga Departamenti Mjedisor, Shoqërorë dhe Qeverisjes së IFC.

Memo e mjedisit dhe shoqërisë ritheksoi shqetësimet që ishin vënë në dukje në shqyrtimin fillestar të vlerësimeve të aprovuara të përmbledhjes së dokumentit të projektit. IFC konkludoi në memon e mjedisit dhe shoqërisë të projektit të Shërbimeve Këshillimore që vlerësimet ofrojnë informacion të mjaftueshëm të sigurojnë që ofruesi i mundshëm për projektin e KEK dinte cilat ishin rreziqet e mjedisit dhe shoqërisë. IFC rekomandoi që ofruesi: të operonte projektin në përputhje me direktivat mjedisore, shëndetësore, dhe sigurisë së IFC; të zbatojë një sistem formal të dokumentuar të menaxhimit të mjedisit, shëndetit, sigurisë dhe shoqërisë; të adoptojë dhe të zbatojë direktivat e shkurtimeve të IFC.

Reported e para të supervizimit të Shërbimeve Këshillimore të IFC, të cilat filluan në tremujorin e katërt të vitit 2010, identifikuan rreziqet/çështjet në vazhdim: reformat e duhura në metodologjinë e tarifave, një model të ri marketimi, dhe reagimin e investitorëve. Në tre mujorin e katërt të vitit 2011, raporti i supervizionit të Shërbimeve Këshillimore vuri në dukje angazhimin në rritje nga organizatat e shoqërisë civile lokale Kosovare dhe organizatat jo

qeveritare që dëshironin të përfshiheshin në vlerësimin e strategjisë për privatizimin e KEK dhe efektet e këtijë privatizimi në Kosovë.

3.3 Marrëveshja Ligjore për Projektin e Shërbimeve Këshillimore të IFC

Marrëveshja ligjore midis IFC dhe Qeverisë së Kosovës kërkonte IFC të përmbushte detyrat në vazhdim:

Faza e parë

- *Diligjenca Ligjore*

Më specifikisht të kryejë dilijencë ligjore në rregullatorin/ligjin, teknik/mjedisor, dhe financiar/çështjet e kontabilitetit në lidhje me ndarjen e shitjes ose koncesionin e kompanisë së shpërndarjes dhe furnizimit të elektrikut.¹⁴ Bazuar mbi gjetjet dhe çështjet e identifikuara gjatë fazës së dilijencës ligjore, IFC do të bënte rekomandimet e ndarjes së aktiviteteve shpërndarëse dhe furnizuese të KEK; transferimit të aseteve, detyrimeve dhe punonjësve; organizatës dhe funksionet e kompanisë së re të krijuar; struktura optimale transaksuese; dhe ndonjë subjekti tjetër, si rregull, ligjor ose konkures, që mund të ketë një impakt të mundshëm në strukturën e transaksionit dhe suksesit. Marrëveshja specifikisht theksoi që IFC do të siguronte ndihmë në dizenjimin e mënyrës më të mirë përse i përket mënyrës se si të merret me stafin e tepërt në mënyrë që të lehtësojë pasojat shoqërore që mund të krijohen si rezultat i ndonjë plani të shkurtimeve paraprake.

Faza e dytë

- *Ndarja dhe përfshirja e aktiviteteve të shpërndarjes.*

Më specifikisht, IFC do të vlerësonte fizibilitetin teknik, financiar, dhe ligjor të kompanisë së re të shpërndarjes si një kompani e pavarur dhe do të rekomandojë strukturën optimale të shpërndarjes së elektrikut dhe sektroit të furnizimit në Kosovë; dhe alokimin më të përshtatshëm dhe në kohë të aseteve dhe detyrimeve dhe transferimi i kontratave, marrëvehjeve, detyrimet, dhe liçensat e kompanisë së re të krijuar.

- *Pregatitja dhe strukturimi i transaksionit të pjesëmarrjes së sektorit privat.*

IFC do të prezantonte dhe diskutonte çështjet kryesore që nevojiteshin të adresoheshin me Qeverinë e Kosovës të bënte të sigurtë strukturën e transaksionit optimal që do të përmbushte objektivat e privatizimit të Qeverisë së Kosovës dhe të tërhiqte një investitor strategjik në shpërndarjen dhe furnizimin e sektorit të energjisë elektrike.

3.4 Përmbledhje e Zbatimit të Projektit të Shërbimeve Këshillimore

IFC përfundoi raportin e Çështjeve Kryesore në Shkurt 2010. Raporti identifikoi gjashtë çështje të rëndësishme kryesore të së ardhmes së shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë

¹⁴ Shprehja shpërndarja dhe furnizimi nuk i referohet prodhimit të elektricitetit, por aktiviteteve që Shpërndarja dhe furnizimi i energjisë elektrike të Kosovës do të ndërmarra.

elektrike: Balanca financiare dhe ekonomike e sistemeve të energjisë elektrike; Lehtësimi I rreziqeve rregullatore; Konsumatorët e vecantë; Humbjet e shpërndarjes dhe çështjet e të ardhurave; Detyrimet e Furnizimit Publik; dhe çështjet Legjislative. Rreziqet e lidhura me alokimin e personelit dhe pakësimin e mundshëm të personelit ishin përfshirë si pjesë e rreziqeve të tjera nën kontekstin e çështjeve që kishin nevojë për vëmendje dhe që ishin më shumë të natyrës procedurore dhe/ose implikacionet e të cilave nuk do të kërkonin udhëzime politike strukturore.

Në Qershor 2011 Qeveria lëshoi një thirrje për shprehje interesi në blerjen dhe funksionimin e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike. Pesë kompani u përgjigjën. Në Janar 2011, u publikua dokumentacioni para kualifikues për tenderat. Katër kompani u përgjigjën në Mars 2011. Në të njëjtën kohë, grupet e Shoqërisë Civile në Kosovë kontaktuan për herë të parë IFC, duke ngritur shqetësimet e tyre përsa I përket transparencës së procesit të privatizimit. IFC u angazhua shpesh me shoqërinë civile gjatë muajve në vazdim, të ndihmojë në përhapjen e informacionit mbi projektin.

Sic u vu re, IFC mbajti një firmë konsultimi me reputacion ndërkombëtar të pregatiste një Vlerësim Mjedisi, Shëndeti dhe Sigurimi të Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike. Kjo përfundoi në Shkurt 2011. Në atë kohë, Korporata Energjetike e Kosovës njohu që praktikatat e shpërndarjes së biznesit nuk ishin në përputhje me standartet ndërkombëtare.

Në kohën kur filloi projekti i privatizimit, mbi strukturën dominuese të qëndrueshmërisë në lidhje me të gjitha aktivitetet e biznesit të IFC, nuk ekzistonin procedura formale të IFC të kryenin një vlerësim të rrezikut Mjedisor dhe Shoqëror për projektet e Shërbimeve Këshillimore. Departamenti i Mjedisit, Shoqërorisë dhe i Qeverisjes së IFC u krijua në Tetor 2010 si një njësi dedikuar projekteve të Shërbimeve Këshillimore. Vlerësimi i Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë iu prezantua njësisë së Departamentit të Mjedisit, Shoqërisë dhe Qeverisjes së IFC për Shërbimet Këshillimore në Gusht, 2011 në përgatitjen e Memos së Mjedisit dhe Shoqërisë, e cila ishte kompletuar në 7 Shtator, 2011. Memo e Mjedisit dhe Shoqërisë rekomandoi që projekti të operonte në përputhje me Direktivat e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë së IFC; zbatimi i dokumentimit formal të sistemit menaxhues të Mjedisit, Shëndetit, dhe Shoqërisë për projektin në përputhje me Kërkesat e Standartit të Performancës numër 1; dhe të miratojë dhe zbatojë direktivat e shkurtimeve të IFC's. Për më tepër, memo e mjedisit dhe shoqërisë rekomandoi që një studim bazë Mjedisi dhe Shoqërie të plotësohet nga fituesi I tenderit, dhe nëse ndonjë Standart Performance ishte shkaktuar në studimin e Mjedisit dhe Shoqërisë, ofruesi i tenderit duhet të identifikonte çështjet specifike dhe propozonte masat lehtësuese.

Skica e Marrëveshjes së Zbatimit u kompletua në Janar 2012. Marrëveshja përbante kërkesat për ofruesin fitues të tenderit që të përputheshin më Standartet e Performancës së IFC dhe direktivave të Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë; të ndërmarrë një studim bazë të Mjedisit dhe Shoqërisë dhe në datën e kompletimit të ofertës të sigurojë punësim të gjithë punonjësve për një minimum kohe tre vjeçar. Ofertat finale u marrën në Maj 2012. Fituesi I tenderit u bë public në Qershor 2012. Gjatë negociimeve finale midis fituesit të tenderit dhe Qeverisë së Kosovës, Kërkesat në marrëveshjen ligjore specifikisht të përputhjes me Standartet e Performancës së IFC u ndryshua në -të përputhen me Parimet e Ekuatorit. Marrëveshja ligjore finale u firmua më 17 Tetor, 2012.

4. Gjetjet e Auditimit të CAO

CAO bën të ditur sfidat domethënëse lidhur me këtë projekt Keshillimor të IFC, dhe aftësisë dhe përpjekjeve që ekipi i IFC ka ushtruar të dhëheq klientin e sajë kur kërkoi të privatizojë Shpërndarjen rrjetit elektrik të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Struktura e Qëndrueshmërisë së IFC, sic është skicuar në Politikën në Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Shoqërore i kërkon IFC të garantojë “që projektet që ajo financon të funksionojnë në përputhje me kërkesat e “Standarteve të Performancës.” Sidoqoftë, Shqyrtim i Proçedurave Mjedisore dhe Shoqërore të aplikuara nuk ofroi udhëzime të qarta se si të përfshijë Standartet e Performancës në Projektin e Shërbimeve Këshillimore. Për më tepër nuk ekzistonin proçedura formale të kryenit vlerësime të rreziqeve Mjedisore dhe Shoqërore për Projektet e Shërbimeve Këshillimore. CAO gjeti që proçedurat e IFC nuk ishin në prespektivë se si agjenda e qëndrueshmërisë e IFC ose kërkesat Mjedisore dhe Shoqërore duhen aplikuar kur ofrohet këshillim.

Sic është theksuar në vlerësimin e përputhshmërisë të këtij rasti, diligenca ligjore e IFC identifikoi shqetësimet lidhur me prodhimin e energjisë shpërndarë nëpërmjet rrjetit dhe parashikon një zvogëlim të theksuar në fuqinë punëtore. Për më tepër ekipi i IFC u përgjigj gjatë zbatimit të projektit të tyre të shqetësimeve rreth perceptimit të mungesës së transparencës në emër të klientit të tyre. Në mënyrë specifike, IFC u angazhua në mënyrë proaktive me organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare in Kosovë.

Përcaktimi i qëllimit të punës të projektit të IFC përse i përket privatizimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike mbështeti ekipin në vendimin e tyre të mos lejojnë pjesën e prodhimit të energjisë elektrike të Korporatës Energjetike të Kosovës të mbi influencojë angazhimin e tyre dhe mënyrën e afrimit tek projekti. Kështu që, këto impakte me potencial të gjere të projektit nuk u konsideruan në lidhje me shqyrtimin mjedisor dhe shoqëror.

Prodhimi i energjisë dhe rrjeti shpërndarës në këtë rast janë ekskluzivisht dhe reciprokisht të varur nga njëri tjetri. Për më tepër privatizimi i kompanisë së shpërndarjes ka qenë i argumentuar të jetë një kusht për prodhimin e energjisë së re për të vazhduar.¹⁵ Në këtë kontekst, CAO përfundon që një konsideratë më e gjerë e rreziqeve dhe ndikimet e këtij projekti do të kishin qenë të përshtatshme veçanërisht në konsideratën e përfshirjes së Bankës Botërore në projektet e prodhimit të energjisë në Kosovë. Trajtim i tillë do të kish çuar IFC të angazhohej në rrezikun e reputacionit të pa analizuar fillimisht që ekzistonte nga lidhja e projektit me natyrën e prodhimit të energjisë në Kosovë.

Termat e Referencës së IFC për këtë projekt specifikuan që IFC kishte për detyrë të identifikonte stafin e tepërt dhe të dizenjonte mënyrën më të mirë se si të merrej me këtë staf në mënyrë që të lehtësonte pasojat sociale që mund të krijoheshin si rezultat i parashikimit të planeve të shkurtmeve. Ndërsa projekti mori zhvillim, Shpërndarja dhe furnizimi i energjisë elektrike të Kosovës u formua si një kompani në zotërim në Gusht 2009, që përbehej nga asetet, përfshirë fuqinë punëtore, kur blerësi i zgjedhur u bë i njohur. Termat e Referencës

¹⁵ Në 28 Qershor, 2010 CAO vë në dukje një prezantim nga Agjencia për Zhvillimin Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID), ku ishte nënvizuar “Pa privatizimin e kompanisë së Shpërndarjes projekti i ri i prodhimit të energjisë mund të jetë më i shtrenjtë ... dhe mund të mos vazhdojë fare.”

specifikuan që udhëzimet e IFC ishin të nevojshme të siguronin që procesi lidhur me stafin e tepërt dhe shkurtimin e tyre ishte njëkohësisht me direktivat e politikave sociale të Bankës Botërore. Sidoqoftë, ky projekt u drejtua nga një tjetër keshilltar. Për pasojë, IFC perceptoi qëllimin e këshillës së sajë në termat e çështjeve të punës si të limituara në lidhje me stafin e KEK të cilët më parë ishin identifikuar të punonin në shërbimet e shpërndarjes dhe furnizimit që do të ndaheshin nga Shpërndarja dhe Furnizimi i Energjisë Elektrike.¹⁶

Ky veprim largoi përfshirjen e IFC në ofrimin e udhëzimeve për sfidat e identifikuar më herët lidhur me stafin e tepërt në lidhje me kompaninë e shpërndarjes. Auditimi I CAO nuk zbuloi ndonjë provë të IFC të ketë shkuar mbi komunikimin normal të sigurojë veten që menaxhimi I stafit brenda kompanisë së shpërndarjes ishte ose do të jetë në përputhje me kërkesat dhe direktivat e IFC.

Leva formale e IFC me klientat e sajë është e limituar në të gjithë shembujt ku kërkesa specifike ose kushtet nuk janë ngritur në marrëveshje përpara firmosjes së dokumentacionit ligjor. Kur ofron Shërbime Këshillimore nën mënyrën aktuale të IFC, klienti është i lirë të marrë në bord ose ta hedhi poshtë këshillën e IFC. Në këtë rast, nuk kishte kërkesë që klienti të pranojë këshillën e IFC, dhe nuk ka prova në dokumentacionin ligjor të Shërbimeve Këshillimore midis IFC dhe klientit të përfshijë besëlidhje të tjera më të vërtetuara në marrëveshjet finale të shitjes/ zbatimit përsa i përket përfshirjes së agjendës së qëndrueshmërisë së IFC. Në përputhje me rrethanat, CAO gjen që IFC anonte kryesisht në levën joformale ku këshilloi klientin në çështjet si të transparencës dhe të qëndrueshmërisë.

Rezultatet në terren në lidhje me çështjet mjedisore dhe shoqërore lidhur me projektin Këshillimor të IFC janë që klienti ka siguruar që njësi që drejton rrjetin nuk do të heqi nga puna staf nga Shpërndarja dhe furnizimi i energjisë elektrike të Kosovës për një kohë tre vëçarë, dhe që klienti i kërkoi njësisë të përmbahet Principeve të Ekuatorit dhe udhëzimeve teknike lidhur me të. Arsyeja që klienti iu referua Principeve të Ekuatorit dhe jo të Standarteve të Performancës së IFC ishte sipas IFC, shqetësimi që i referohej dispozitave të zotëruara nga një financier potencial specifik që do të dërgojë mesazhin që klienti ishte i anshëm ndaj pranimin të financimit nga IFC, krahasuar me financierët e tjerë potencialë.

CAO gjeti që IFC nuk kishte ndonjë mënyrë të strukturuar të vlerësonte premtimin ose kapacitetin e klientit të zbatonte axhendën e qëndrueshmërisë të IFC, dhe kështu nuk kish ndonjë mënyrë se si të vlerësonte mundësinë që leva joformale do të ishte e mjaftueshme në sigurimin e miratimit të Standarteve të Performancës së IFC.

CAO gjen që kushtet jo formale ishin aplikuar në mënyrën që të zbatojë miratimin e axhendës së qëndrueshmërisë së IFC nga Klienti i Shërbimeve Këshillimore të IFC.

¹⁶ Sidoqoftë, CAO vë në dukje: Vlerësimin e Progresit të KEK drejt Privatizimit të USAID (Prill 2009), i cili nënvizoi që identifikimi i stafit për mbështetjen e njësisë së biznesit të KEDS nuk ishte vendosur akoma.

Përfundimet e Auditit të CAO

Përfundimet në lidhje me Projektin # 29107

Me një përjashtim në lidhje me renditjen e disa dokumentave të brendëshme të IFC, CAO gjen IFC të jetë në përputhje materiale me procedurat e aplikuara në atë kohë. CAO bën të ditur sfida të konsiderueshme që ekipi I IFC përballoi, dhe aftësitë dhe burimet e duhura dhe të shpërndara të përfundojë angazhimin.

Nëse janë apo jo detyra specifike rezultoi të jenë më të limituara në qëllim se sa ishte parashikuar fillimisht, CAO konsideron që IFC nuk adresoi çështjet lidhur me fuqinë punëtore në Shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike të Kosovës siç ishte shprehur në qëllimin fillestar.

CAO konsideron që IFC kishte vlerësuar në një masë më të madhe kontekstuale pasojat e mjedisit dhe shoqërisë të objekteve të prodhimit të energjisë në qëllimin e punës së projektit të Shërbimeve Këshillimore, ajo mund të kish siguruar qartësi më të madhe ndaj palëve të jashtme të interesuara rreth qëllimit të punës së IFC.

Këto mangësi nuk përbëjnë një shkelje të procedurave të aplikuara të IFC, kryesisht sepse procedurat e aplikuara në atë kohë nuk ishin urdhëruese. Sidoqoftë kjo shpie CAO të ngrejë shqetësimet e efektshmërisë së kërkesave Mjedisore dhe Shoqërore të IFC dhe të Strukturës së Qëndrueshmërisë së IFC kur u aplikua tek Shërbimet Këshillimore të IFC.

Konkluzionet lidhur me Strukturën e Qëndrueshmërisë dhe Procedurave

Struktura e Qëndrueshmërisë e vitit 2012 e IFC thotë që të gjitha këshillat e dhëna nga IFC do të jenë në pajtim me Standartet e Performances, dhe që Standartet e Performancës ndihmojnë klientat këshillimorë të IFC të menaxhojnë dhe përmirësojnë performancën e tyre mjedisore dhe shoqërore.

Struktura e Qëndrueshmërisë e 2006 dhe 2012 e IFC angazhohet të kërkojë rezultate pozitive të zhvillimit në aktivitetet e saja. Sidoqoftë nuk ekziston një strukturë se si të vlerësojë angazhimin e një klienti të Shërbimeve Këshillimore dhe gjasat që ata do të marrin në agjendën e Qëndrueshmërisë së IFC. Është përfundimisht nën lirinë e veprimit të klientit të marrë në bord ose nënvlerësojë Këshillën e IFC.

CAO arrin në përfundimin që nga mungesa e levës formale e IFC, dhe mungesa e vlerësimeve të strukturuar të levës "joformale" të sajë, kur I ofron Shërbimet Këshillimore një klienti, IFC nuk është në gjendje të sigurojë veten më përpara se deri në çfarë shkalle është e mundur që angazhimi i sajë do të çojë në përmirësimin e rezultateve mjedisore dhe shoqërore, ose të përmbushë angazhimin politik të sajë të "mos dëmtojë."¹⁷

¹⁷ Specifikisht; "Në qëndër të misionit të zhvillimit të IFC janë përpjekjet e saja të zbatojë investimet dhe aktivitetet këshillimore me qëllim të "mos dëmtojë" njerëzit dhe mjedisin, për të rritur qëndrueshmërinë e operacioneve të sektorit privat dhe në tregjet që ata punojnë, dhe të arrijë rezultate pozitive të zhvillimit". IFC (2012) *Politika në Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Shoqërore*.

http://ww1.ifc.org/wps/wcm/connect/Topics_Ext_Content/IFC_External_Corporate_Site/IFC+Sustainability/Sustainability+Framework/Sustainability+Framework+-+2012/#SustainabilityPolicy (Hyrë më 12 Shkurt, 2013)